



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 10 shtator 2015, në mbledhjen e XX-të (njëzet) – e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

➤ **Gjendja aktuale në arsim në Komunën e Podujevës me theks të veçantë në fshatin Halabak**

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit, dhe konstatoi pjesëmarrjen e këshilltarëve të Kuvendit. Ndër të tjera shtoi, ju njoftoj se thirrja e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme është bërë në bazë të nënshkrimeve të 14 këshilltarëve të Kuvendit, lidhur me këtë unë kam biseduar me këshilltarin z.Haki Rudari të cilin e kam informuar se në bazë të Planit të Punës së Kuvendit në muajin shtator ndër pikat tjera është edhe informata e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2015/2016, dhe i kam rekomanduar që në muajin tetor kemi mundësi t'i mbajmë dy mbledhje të Kuvendit në mënyrë që deri në fund të vitit të përmbushim dymbëdhjetë mbledhje të Kuvendit ashtu siç edhe e kemi paraparë buxhetin përkatës, por insistimi i tij ka qenë që të thirret kjo mbledhje, ne kemi respektuar rregullat ligjore dhe e kemi thirr mbledhjen ashtu siç është kërkuar. Sa i përket thirrjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme unë sugjeroj që mbledhje të tilla thirren atëherë kur vërtetë kemi ndonjë gjendje të jashtëzakonshme, e them këtë duke u bazuar në planin e punës së Kuvendit për këtë vit sipas të cilit informata përkatëse nga Drejtoria e Arsimit është e paraparë të jetë në fund të këtij muaji, informatë e cila ka qenë duke u përgatitur dhe për këtë sigurisht se do të ishte më e lehtë të debatohej, kurse sot jemi të mangët sa i përket kësaj pike sepse nuk e kemi materialin e nevojshëm, përveç debatit për gjendjen e krijuar në fshatin Halabak, mirëpo nëse sot debatojmë në përgjithësi për arsimin ashtu siç është cekur në thirrje atëherë në mbledhjen e radhës nuk kemi çka të debatojmë më për këtë temë, por si do që të jetë kjo është e drejtë e juaja e cila edhe është respektuar.

Fillimisht fjalën ja jap z.Haki Rudarit si propozues i kësaj thirrjeje në mënyrë që t'i jap arsyetimet e thirrjes së kësaj mbledhjeje se çka është menduar se është e jashtëzakonshme. Gjithashtu sa i përket debatit kërkoj të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit, duke përfshirë kohën, rendin, e të tjera.

z.Haki Rudari, theksoi, konsideroj se kur afër 100 nxënës qëndrojnë të bllokuar në shtëpitë e tyre, për ne është gjendje e jashtëzakonshme. Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës së Podujevës dhe nenin 25 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Kuvendit, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, i mbështetur nga Grupi i PDK-së, këshilltari nga radhët e AAK-së, këshilltari nga radhët e LB-së dhe kolegu z.Kadri Avdiu nga radhët e Grupit Plus, kemi thirr këtë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës me një pikë të vetme të rendit të ditës, *Gjendja e krijuar në arsim në Komunën e Podujevës me theks të veçantë në fshatin Halabak*. Të nderuar, ndonëse 1 shtatori është një datë që me mijëra nxënës gëzohen për fillimin e vitit të ri shkollorë, për 85 nxënës dhe prindërit e tyre në fshatin Halabak ky gëzim mungoi si pasoj e djegies së shkollës dhe ashtu në gjendje të mjerueshme. Fatkeqësisht edhe ky vit shkollor po fillon me probleme të shumta në Komunën tonë, ajo çka mbahet në mend për qeverinë lokale dhe atë qendrore janë deklaratat shpresëdhënëse për investime në arsim, por që në fakt mbeten vetëm premtime elektorale, ngase premtimet për ndërtimin e shkollës në atë fshat ishin dhënë shumë më herët. Po të kishte vullnet dhe përkushtim qeveria për ndërtimin e objekteve mësimore siç po bënë për shkuarjen në Bruksel dhe nënshkrimin e marrëveshjeve në dëm të vendit apo kursimet nga pagesat për komisionet që në fund po falin territor të vendit tonë, e konfirmuar edhe nga një deputet i LDK-së, kjo mbledhje nuk do të mbahej fare ngase ata banorë do të kishin shkollën e tyre. Duke lexuar deklaratën e Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, dhe të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollorë, gjatë vizitave që bëmë në terren gjendja ishte e kundërt. Më lejoni t'i paraqes përshtypjet që kemi marrë rreth gjendjes në terren. Më 03.09.2015 kam vizituar fshatin Halabak dhe kam biseduar me kryetarin e këshillit të prindërve Nexhat Pllana i cili tregon se si nxënësit kanë mbetur nëpër shtëpitë e tyre si pasoj e djegies së objektit të shkollës dhe largësisë së madhe për të shkuar këmbë në shkollën e Tërrenavës, propozim i dhënë nga zyrtarët komunal, ndonëse kishte nxënës të cilët më shumë se 5 km largësi për të shkuar në atë shkollë, andaj t'iu thuhet nxënësve të klasës së parë udhëtoni në atë largësi këmbë, mendoj se është diçka e jashtëzakonshme. Në nenin 3 të Ligjit për arsimin parauniversitar, thuhet; 1-asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsim, dhe 2-është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, Komunave, Institucioneve arsimore dhe organeve tjera për krijimin e infrastrukturës së përgjithshme, pra kjo duhet të vlejë edhe për banorët e fshatit Halabak. Gjendje jo e mirë është edhe në vendbanime tjera, nxënësit e fshatit Kaçybeg udhëtojnë këmbë disa kilometra edhe për kundër rrezikut gjatë udhëtimit, pastaj objektet tejet të vjetruara në fshatrat Llapashticë e Ulët, Bajqinë e tjera. Më 08.09.2015 Grupi i këshilltarëve të LVV-së kemi vizituar shkollat fillore të qytetit, "Shaban Shala", "Naim Frashëri" si dhe shkollën e mesme ekonomike "Isa Boletini", ku gjatë bisedave me drejtorët e këtyre shkollave identifikua një gjendje të cilën do të paraqes në vijim; rrethoja të dëmtuara në shkollën "Shaban Shala" dhe për pasoj zëvendësdrejtoretsha e shkollës thotë se kemi rrezikun e nxënësve nga futja në oborrin e shkollës dhe e atyre që nuk janë nxënës si dhe shitjet që bëhen nga qytetarët afër këtij objekti. Ajo çka vlen të

potencohet është se nxënësit e shkollës fillore “Naim Frashëri” me rastin e daljes në objektin e ri të shkollës do të kenë disa dhoma mësimi më pak dhe për pasoj kabinetet do të shndërrohen në dhoma të mësimi gjë e cila për ne është e papranueshme dhe tejet shqetësuese sepse ne mendojmë se kur diçka ndërtohet e re bëhet për diçka të mirë e jo të ndërtohet një objekt me një shumë të madhe buxhetore ku realisht në fund del me mungesë të dhomave të mësimi. Në SHME “Isa Boletini” një nga vështirësitë ishte se rreth 200 nxënës kanë mbetur pa u regjistruar kurse dy klasë janë shëtitore, andaj kur kemi rreth 200 nxënës pa u regjistruar kurse në anën tjetër dy klasë mbesin të zbrazëta dhe vetëm shërbejnë për shëtitore, mendojmë se duhet të themi se është diçka e jashtëzakonshme, të paktën ne mendojmë ashtu. Më 09.09.2015 ne kemi vizituar shkollën fillore të re ku ndër të tjera hasëm në këtë gjendje; furnizimi me libra jo i mirë sidomos me abetaren ku prej 110 nxënësve vetëm 40 janë pajisur me atë si dhe ishte salla e sportit por mungojnë elementet e domosdoshme për mbajtjen e orës mësimore, gjendje të cilën e kam marrë një ditë më parë nga drejtori i shkollës së re. Në shkollën e mesme teknike “Fan S. Noli” ndër të tjera kemi hasur në këtë gjendje; mungesë të normës së plotë të shumë profesorëve, salla e sportit nuk është funksionale si pasoj e mungesës së dyshemesë që nuk do të ishte ndonjë investim i madh por më shumë do të thoja se është mosinteresi i Kuvendit komunal, respektivisht Drejtorisë së Arsimit dhe Qeverisë komunale, pasta preokupim ishte mbetja e 80 nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm pa u regjistruar, a mund të thoni se është dashur të presim edhe 3 javë për të thirrur një mbledhje të rregullt të Kuvendit dhe tek atëherë të debatojmë për ata nxënës, mendoj se kjo e arsyeton më së miri këtë mbledhje madje konsideroj se ndoshta kjo është një nga mbledhjet më të rëndësishmet që është thirrur. Të nderuarë më lejoni që në vazhdim t’i paraqesë disa nga problemet serioze me cilat po ballafaqohet arsimi në Komunën tonë, si probleme dhe preokupime të përgjithshme që ne i kemi vizituar në shkollat e qytetit dhe nuk do të ndalemi me vizita edhe në vendet rurale; -mungesa e objekteve të reja shkollore, -mungesa e investimeve në pajisjen e shkollave me laboratore dhe kabinete, mungesa e sallave dhe fushave sportive, -furnizim me tekste shkollore jo i mirë dhe jo i rregullt ku ne që punojmë në arsim jemi në dijeni se tani po kalon edhe java e dytë pa tekste shkollore, -mungesa e fotokopjuesve në shkollë, -politizimi i skajshëm i arsimit, -pranimi i kuadrit pa kritere dhe mungesa e transparencës, -fshehja e orëve të mësimi në disa shkollë, -mësimi zgjedhorë organizohet sipas dëshirës e jo nevojave të nxënësve, -kurse private nëpër shkollë nga arsimtarët që punojnë në shkollat e njëjta, -mungesa e punës praktike sidomos në shkollat profesionale të qytetit, -ekskursione të nxënësve jashtë vendit të organizuara jo mirë gjë për të cilën ndoshta do të debatojmë më vonë. Prandaj të gjitha këto na tregojnë se gjendja e arsimit në Komunën e Podujevës nuk është e mirë, dhe kërkoj që të gjithë të mobilizohemi dhe të kontribuojmë në ngritjen e cilësisë së arsimit që konsideroj se është synim i të gjithëve.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës shprehim keqardhje për rastin e djegies së objektit të shkollës në fshatin Halabak, njëkohësisht vlen të përhëndetet angazhimi i madh dhe i vazhdueshëm i Kryetarit të Komunës së Podujevës z.Agim Velu për rregullimin e objekti të shkollës së fshatit Halabak, kërkesë kjo e bërë edhe shumë më parë nga Kryetari i Komunës. Gjithashtu Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së – dega Podujevë, kërkon që organet e rendit të merren me zbardhjen e rastit të djegies së shkollës në fshatin Halabak.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, z.Haki Rudari u ndërlidh paksa rreth politikave nacionale, konsideroj se mandati jonë si këshilltarë të Kuvendit ka të bëjë me politika dhe probleme lokale, po ashtu z.Fidan Rekaliu e shprehi shqetësimin e tij por edhe të subjektit që i takon, për rastin e djegies së asaj shkolle, mirëpo sa jam në dijeni ka dhjetë vite që ish shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së bënë kërkesë për ndërtimin ose marrjen e masave për objektin e cekur. Ne kemi qenë në dijeni se ai objekt është në gjendje të keqe dhe do të përfundoj keq, sikurse që jemi në dijeni edhe për dy-tri shkolla tjera të cilat janë në një gjendje të tillë dhe pa kushte për mësim. Konsideroj se organet e rendit është dashur që deri tani të japin një përgjigje rreth djegies së shkollës në fshatin Halabak, sikurse që është dashur Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi të mbaj një mbledhje dhe të dalin me një deklaratë rreth asaj ngjarjeje. Unë personalisht paksa e kam të vështirë t'i drejtohem drejtorit aktual të Drejtorisë së Arsimit sepse problemet janë lënë nga ish drejtori i kësaj Drejtorie i cili e ka bërë këtë trase të rrugës dhe tani është emëruar Nënkryetar i Komunës, por meqë tema është e tillë, ne patjetër duhet t'i drejtohem drejtorit të ri të Drejtorisë së Arsimit. Sa i përket arsimit në përgjithësi mendoj që nuk duhet të kemi pikëpamje politike në lidhje me investimet dhe me këtë shfrytëzoi rastin të falënderoj z.Arsim Bajramin Ministër i MASHT-it i cili e ka vizituar shkollën e djegur dhe ka premtuar se shumë shpejt në procedurë të përshpejtuar do të ndërtohet objekti i ri, kurse tani mbetet të shihet angazhimi i Kryetarit të Komunës dhe i Ministrit të cekur. Çështje e rëndësishme është se në atë objekt është djegur i gjithë dokumentacioni që ka qenë, andaj si pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit është se si do të evidentohen nga arkivat, dokumentacionet e asaj shkolle gjegjësisht rezultatet e nxënësve e gjëra tjera, po ashtu shqetësim paraqet edhe stafi arsimorë i asaj shkolle ngase do të mbesin pa punë dhe nuk jam në dijeni se si do të rregullohet çështja e kompensimit-pagës për atë staf, por që ata 5 mësimdhënës dhe 1 punëtor teknik kanë kontrata të vlefshme, kurse nuk japin mësim për shkak të objektit të djegur, nxënësit janë shpërndarë në shkollën e fshatit Tërrnavë, ndërsa kompensimi i pagesës sigurisht se do të kërkohet, dhe ai duhet të bëhet në mënyrë ligjore. Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës ka kërkuar edhe më parë në këtë Kuvend që të debatohet për arsimin, gjendje për të cilën sigurisht se jemi në dijeni të gjithë se kjo është vazhde e viteve të mëparshme sepse po ashtu drejtori i ri i Drejtorisë së Arsimit ka ardhur nga pozita e drejtorit të shkollës "Enver Maloku" e cila është me performancën më të dobët dhe me çrregullimet më të mëdha e që mendojmë se nuk është bërë përzgjedhje e duhur për tu zgjidhur problemet e arsimit. Çështje tjetër është se dy drejtorët e fundit të Drejtorisë së Arsimit janë në dijeni se në vitin e kaluar 11 shkolla kanë qenë vetëm me ushtrues detyre të drejtorit kurse në këtë vit me një gjendje të tillë janë 24 shkolla, ndërsa konkursi është anuluar dy herë radhazi, pas ngritjes së kësaj çështjeje nga subjektet opozitare se qëllimet janë për pozicionim të personave politik, e që mendoj se koha orëve politike në arsim ka përfunduar me rënien e sistemit komunistë, gjëra për të cilat Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës publikisht kërkon që orët politike në arsim të hiqen, pozicionimi i drejtorëve, kuadrit të profilit për profesorë të ciklit të mesëm të ulët dhe të mësuesve të bëhet me performancë të arsimit dhe me përgatitje profesionale, e jo në baza politike, nga cilido subjekt politik qofshin ata. Në mbledhjen e parë të Kuvendit që ka filluar punën drejtori i ri i Drejtorisë së Arsimit, unë kam shtruar pyetje, a do të ketë profesorë pa përgatitje profesionale gjatë mandatit tuaj, kurse drejtori nuk ka mundur të përgjigjet me jo. Tani në shkollat e Komunës së Podujevës ka profesorë me shkollë të

mesme të cilët ligjërojnë në shkolla të mesme, prandaj edhe kemi të tillë rezultatit e nxënësve, performancën e shkollave dhe për numrin e nxënësve Llapjan të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen në fakultete për shkak të rezultateve negative. Shqetësim tjetër është edhe përzgjedhja e dy kompanive për shpërndarjen e librave të cilat e kanë vështirësuar shpërndarjen e librave nëpër shkolla ku tani veç po hyjmë në javën e dytë të fillimit të vitit të ri shkollorë dhe ende nuk ka shpërndarje të rregullt për arsye se janë marrë me këtë çështje dy kompani prej nga vijnë subjektet. Çështje tjetër është, nxënësve të cilët nuk kanë mundur të kalojnë testet iu është rënduar buxheti familjeve të tyre sepse ata nxënës mund të regjistrohen vetëm në ndonjë kolegji privat ku duhet të paguajnë rreth 1,500 € për një vit, pra do të duhej që prindërit e nxënësve të komunikojnë më shumë me drejtor të shkollave dhe me qeverisjen komunale në mënyrë që mësimnxënia të jetë më e mirë, ndërsa përgjigja e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ishte se ka rënie të rezultateve sepse nuk kemi lejuar nxënësit të kopjojnë, përgjigje për të cilën mendoj se është joprofesionale për një drejtor të Drejtorisë së Arsimit.

Lidhur me shkollën e re që u çek nga kolegu nga radhët e LVV-së, në raportin financiarë për gjashtëmujorin e parë të vitit çeket, shpenzime në shkollën "Ibrahim Rugova", për të cilën konsideroj se ende nuk është marrë një vendim në këtë Kuvend për emërtimin e asaj shkolle, pavarësisht se emërtimi me emrin e ish Presidentit të Republikës së Kosovës është i pranueshëm për të gjithë, mendoj se duhet të merret një vendim zyrtar, andaj nuk di se si do të shkruan në diplomat e atyre nxënësve të cilët e kryejnë shkollimin në atë shkollë, pra Drejtoria e Arsimit është dashur që të sjellë një kërkesë dhe t'i rekomandon Kuvendit që emërtimin i asaj shkolle të bëhet në mënyrë zyrtare, gjë të cilën sigurisht se do të mbështetnim të gjithë sikurse çdo emër tjetër i cili ka dhënë kontribut dhe që meriton të ketë atë në ndonjë institucion, e ngrita këtë ngase mendoj nuk mund të shkruhet në diploma të nxënësve, shembull, përfundoj klasën V-të në shkollën e re. Mandej në shkollat tona ka mësimdhënës universal të cilët i japin nga shtatë lëndë, shembull konkret në fshatin Gërdoc, një mësimdhënës i jap shtatë lëndë, pra dua të them se kjo dhe shumë gjëra tjera e kanë qenë arsye e thirrjes së kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, dhe ne si subjekt nga radhët e PDK-së kemi bërë edhe kërkesë që të jetë mbledhje e rregullt dhe të debatohet për arsimin.

Po ashtu drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Avni Maloku ka emëruar ushtrues detyre të drejtorëve nëpër shkolla të cilat kanë më pak se 180 nxënës, gjë për të cilën konsideroj se nuk janë respektuar aktet e nxjerra nga MASHT, sepse të gjitha shkollat të cilat kanë numër më të vogël se 180 nxënës, në çoftë se emërohet drejtor ose ushtrues i detyrës së drejtorit të shkollës duhet të ketë edhe minimum 10 orë mësimore për tu paguar me normë të plotë përkatëse, kurse unë jam në dijeni se me nënshkrim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në fshatrat Bërvenik, Dyç, Herticë Zhiti dhe Murgull janë emëruar ushtrues të detyrës së drejtorit të shkollës të cilët nuk kanë orë mësimore apo thënë ndryshe nuk japin mësim. Gjithashtu për fillimin e vitit të ri shkollorë nuk janë bërë përgatitjet teknike për bartjen e nxënësve në shkolla dhe anasjelltas, madje javën e kaluar drejtori i Drejtorisë së Arsimit, në pyetjen e një qytetari në lidhje me këtë çështje, është përgjigj se ende nuk janë bërë përgatitjet teknike dhe ende nuk është hapur tenderi për bartjen e nxënësve, çështje për të cilën mendoj se pas dy javëve të fillimit të vitit të ri shkollorë nuk mund të hapet tenderi apo të shpërndahen tekstet shkollore një muaj pasi të fillon mësimi. Mandej në shkollën e fshatit Sfeqël vajza e sekretarit të shkollës jep gjuhë angleze, mund të pyesni sekretarin e shkollës se çfarë përgatitjesh ka ajo

mësimdhënëse e cila e jep lëndën e gjuhës angleze. Pra kjo mbledhje e jashtëzakonshme është thirr për gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës me theks të veçantë për shkollën e fshatit Halabak që është një gjendje e jashtëzakonshme dhe që ende nuk ka një përgjigje publike rreth asaj gjendjeje, dua të them se gjendja në arsim është tejte e rëndë dhe Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës publikisht kërkon të hapet konkursi dhe të emërohen drejtorët e shkollave. Vlen të ceket se portaleve informative Koha Ditore dhe Llapi Info, në pyetjen e tyre se kur do të hapet konkursi për drejtor të shkollave, drejtori i Drejtorisë së Arsimit iu është përgjigjur se nuk kemi kohë njëherë të merremi me këtë çështje sepse jemi në procedura të rekrutimit të personelit arsimorë, kështu që unë mendoj që së pari duhet të emërohet drejtori i shkollës e pastaj të rekrutohen mësimdhënësit, andaj kërkoj që të hapet prapë ky konkurs dhe ju bëj thirrje të gjithë profesorëve të cilët i përmbushin performancën, pavarësisht cilit subjekt politik i takojnë, të konkurrojnë në konkursin për drejtor shkolle, përndryshe nëse mendon drejtori i Drejtorisë së Arsimit të sistemoi drejtorët në baza politike ne do t'i përdorim të gjitha normat ligjore në mënyrë që të mos lejojmë një gjë të tillë, dhe ashtu sikurse që është anuluar dy herë konkursi i cekur do të ndodh edhe për të tretën herë derisa të rregullohet sistemi i arsimit në Komunën tonë.

z.Kadri Avdiu, theksoi, fillimisht dua të ndërlidhem rreth thirrjes së kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, thirrje e cila është bërë me theks të veçantë për shkak të gjendjes në fshatin Halabak. Një pjesë e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës mund të mos jetë e informuar rreth gjendjes së shkollës në fshatin Halabak, mirëpo me që vij nga ai lokalitet jam i obliguar t'iu informoj se, unë edhe në mandatet e kaluara disa herë në këtë foltore kam kërkuar të ndërmerren masa dhe të ndërtohet një objekt i ri shkollor në atë fshat, madje personalisht, në cilësinë e qytetarit por edhe të këshilltarit të Kuvendit, kam kërkuar edhe në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ka pasë premtime nga Ministri paraparak se në vitin 2014 objekti i asaj shkolle do të ndërtohet, por nuk është ndërmarrë asgjë asnjëherë. Shkolla e Halabakut është nga klasa I-rë deri në të e V-tën dhe pjesë e shkollës amë të fshatit Tërnavë e cila ka qenë shumë e vjetër ku fillimisht ka funksionuar si mejtep e pastaj kanë filluar të mësohen shkronjat e para të Gjuhës Shqipe nga disa mësues të asaj kohe, ndërsa tani jemi para një gjendje të rëndë sepse i gjithë dokumentacioni i historikut të asaj shkolle është djegur dhe për këtë sinjerisht ju them se ndjej dhimbje të madhe. Nuk jam ndonjë ekspert i kësaj natyre se si ka mundur të ndodh kjo, nga sistemi i vjetruar i rrymës apo mund të ketë ndodh nga ndonjë dorë e zezë, e quaj kështu sepse një dorë e cila djegë ndonjë institucion shtetëror nuk ka si të quhet tjetër përveç dorë e zezë, për shkak se nuk kemi të bëjmë vetëm me objektin e shkollës por aty ka pasur edhe dokumentacione të ndryshme shkollore të rëndësishme.

Është organizuar një takim dhe nga banorët e fshatit jam ftuar në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të jem pjesëmarrës, ftesë të cilës iu kam përgjigj pozitivisht, kam dëgjuar shqetësimet dhe brengat e tyre për të cilat mendoj se janë të arsyeshme dhe jam munduar të jap kontributin tim në mënyrën më të mirë të mundshme që të tejkalohet ajo gjendje, në përfundim të takimit është vendosur të caktohet një komision prej pesë prindërve të nxënësve, komisioni i cili ka marrë përgjegjësi t'i drejtohet dhe iu ka drejtuar drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, Nënkyetarit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës, pastaj i është drejtuar edhe Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, mandej komisioni prapë ka thirr një takim të prindërve për t'iu komunikuar rezultatet e takimeve me të lartcekurit, ku ndër të tjera është thënë që jemi pranuar shumë mirë nga

të gjithë dhe kemi marrë premtime pozitive, pastaj ata prindër - banorë të fshatit kanë vendosur që përderisa të vije një vendim me shkrim nga Kryetari i Komunës apo Ministri i MASHT-it, nxënësit e tyre nuk do të vijnë në mësimet në asnjë shkollë tjetër por do të ndërmarrim veprime që ata fëmijë të mësojnë në ndonjë objekt të fshatit, në Xhami ose në ndonjë shtëpi private të fshatit. Në ditën që është nënshkruar thirrja e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, thirrje të cilën unë e kam nënshkruar dhe do të nënshkruaj kurdo që paraqitet nevoja për ndihmë të nxënësve të cilitdo lokalitet qofshin ata, për fat të mirë atë ditë Ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë z.Arsim Bajrami e ka vizituar atë fshatë dhe me vete ka sjellë vendimin që ajo shkollë do të ndërtohet në procedurë të shpejtë. Në deklaratën publike të Ministrit ndër të tjera thuhet, se është sugjeruar nga Kryetari i Komunës, pastaj Qeveria e Republikës së Kosovës një ditë më parë ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme ku unë si Ministrë i MASHT-it dhe Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës jemi zotuar që në fshatin Halabak të ndërtohet objekti i ri i shkollës brenda 2-3 muajve, deklaratë të cilës unë personalisht i gëzohem shumë dhe dashtë Zoti që ndërtimi i asaj shkolle të bëhet realitet në mënyrë që nxënësit e atij fshati t'i vijnë në mësimet e rregullta.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Kadri Avdiu i cili në mënyrë kronologjike i bëri sqarimet e nevojshme rreth gjendjes së krijuar pas djegies së objektit të shkollës në fshatin Halabak.

z.Avni Ajeti, theksoi, gjatë diskutimit të këshilltarit z.Rafet Llapashtica, kur ishte fjala për djegien e shkollës së fshatit Halabak, nuk di sa e dëgjua me vëmendje të gjithë, mirëpo me apo pa vetëdije e tha se, ne e kemi ditur se si do të përfundoj kjo çështje. Unë nuk dëshiroj të paragjykoj asgjë, por vetëm dua që këshilltari i cekur të sqaroj edhe se në çfarë forme e ka ditur këshilltari i cekur këtë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, jemi në demokraci dhe e respektoj pyetjen e parafolësit z.Avni Ajeti dhe paragjykimin se si e ka kuptuar ai fjalimin tim, nuk dua të them se parafolësi nuk ka mundur të kuptoj atë pjesë nga fjalimi im, mirëpo meqë ishte pyetje unë po jap përgjigje, e njëjta gjendje është edhe në shkollën Murgull - Zhiti dhe këtë e kam si mostër, po ashtu e ceka se ende nuk kemi përgjigje nga organet e rendit për djegien e shkollës së fshatit Halabak dhe kërkova përgjigje ose të paktën të dalin me deklaratë, mandej e ceka se Kryetari i Komunës dhe Komandanti i Policisë janë pjesë e KKS-së dhe asnjëherë nuk kanë raportuar në Kuvendin e Komunës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës dhe gjithëherë gjendja e sigurisë është cilësuar stabile, po ashtu gjatë vizitës së Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme gjendja e sigurisë është cilësuar stabile sa i përket fundamentalizmit, kurse unë jam në dijeni sikurse që është edhe parafolësi dhe qytetarët tjerë se në fshatin Zakut në një lokacion të ndarë për varreza, ashtu siç kam dëgjuar unë, fundamentalistët në bashkëpunim me një drejtor të Komunës dëshirojnë të ndërtojnë një Xhami pa leje të Bashkësisë Islame. Gjithashtu e njëjta gjendje sikurse në fshatin Halabak është edhe në shkollën "Luigj Gurrakuqi" në fshatin Batllavë në të cilën nuk ka kushte për mësim. Pra kjo është përgjigja ime për këshilltarin parafolës i cili sigurisht ka menduar se unë po them se ne kemi qenë në dijeni se kush do të djeg shkollën e cekur. Nëse ka qenë angazhim i madh i Kryetarit të Komunës, Ministrit të MASHT-it, Kryeministrit të kaluar dhe këtij aktual, mendoj se ajo shkollë nuk është dashur të lihet në atë gjendje sepse rreziku i djegies ose shembjes së saj ka ekzistuar në çdo moment sikurse që ekziston edhe në disa shkolla tjera.

z.Flakron Gashi, theksoi, jemi thirr në këtë mbledhje të jashtëzakonshme për gjendjen e krijuar në arsim me theks të veçantë për shkollën e fshatit Halabak, mendoj se jo vetëm shkolla ndikon që gjendja të jetë e tillë por kjo gjendje ka ndikuar edhe nga vitet kaluara dhe rruga që është trasuar deri më sot. Gjendja e arsimit në Komunën e Podujevës sot në këtë mbledhje është duke u paraqitur si e tillë sa që krijohet përshtypja se jemi duke debatuar për dy Komuna të ndryshme, varësisht prej këndit politik pozitiv apo negativ, por vetëm një e vërtetë qëndron dhe askush nuk mund të mohoj, arsimi në Komunën tonë është politizuar tej mase, madje pozitivat e profesorëve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve, sekretarëve, punëtorëve teknik, bibliotekistëve, edukatoreve dhe të mësuesve negociohen sikur të ishin emërime të emisarëve politik. Nuk justifikohet rasti se nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është anuluar konkursi për drejtorë të shkollave sepse nuk janë përmbushur kriteret dhe kushtet e parapara me legjislacionin në fuqi, por përgjegjësia duhet kërkuar nga drejtorët pararendës ndaj qasjes dhe kuadrove që janë brendapërbrenda sistemit arsimorë, ka raste që konkursët nuk janë hapur konform Udhëzimeve Administrative ku parashihet të hapen tre muaj para skadimit të kontratës kurse kanë kaluar madje edhe vite. I nderuari drejtor i Drejtorisë së Arsimit, ka raste që konkursët nuk janë hapur fare në disa shkolla edhe pse sipas ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar një gjë e tillë duhet të ndodhte, e kjo gjë nuk ka ndodhur për shkak se rrezikon marrëdhënien e punës së disa aktivistëve të LDK-së të cilët ndoshta pa meritë i mbajnë ato vende të punës. Është shumë e vështirë të dilet nga kjo gjendje sepse është krijuar një labirint i orëve ku sot në Komunën e Podujevës ka profesorë të cilët mbajnë lëndë të shpërndara nëpër shumë shkolla e të cilat do të mund t'i jepnin vetëm në një shkollë, mirëpo nuk ka pasur një strategji të veçantë. Në vazhdim do t'i numëroj disa raste të shkeljeve ku prapë edhe në këtë vit sikurse viteve tjera, nuk di si mund të jetë kjo ko incidencë, që në mesin e të pranuarve si kuadro të reja të jenë të afërm të familjarëve të drejtorëve. Pastaj në shkollën e mesme "Isa Boletini" lëndët praktike profesionale nuk mbahen pothuajse asnjëherë edhe pse janë pjesë e planprogramit, gjë për të cilën mund të pyesni edhe nxënësit e asaj shkolle, dhe për këtë dikush duhet të jap përgjigje. Mandej, prapë sikurse viteve tjera në shkollën teknike "Fan S. Noli" ka parregullsi të mëdha, nuk janë hapur fare konkurse për të paktën gjashtë raste edhe pse kualifikimi dhe grada e atyre është bachelor me sistem trevjeçarë dhe madje sipas Udhëzimit të ri Administrativ nuk i kanë nga tri vite përvojë pune, gjëra për të cilat në vitin e kaluar ish drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Nexhmi Rudari i pati cilësuar si deklarata të nxituara politike mirëpo mediat i kanë vërtetuar të gjitha ato që unë i kam thënë, e kam thënë dhe e përsërisë se për fjalën e thënë mbaj përgjegjësi dhe për hirë të korrektësisë nuk dëshiroj që sot të përmendi emra dhe mbiemra dhe lëndë përkatëse se kush janë ata profesorë, por nëse dëshironi mund edhe të përmendim, madje ka familjarë të drejtorëve, reja të drejtorëve, militantë të LDK-së e të ngjashëm. Gjithashtu, kur flasim për një gjendje nuk mund të flasim pashkëputshëm edhe për vitet e kaluara, në shkollën e mesme teknike "Fan S. Noli" është rasti që në arsimin për të rritur ose arsimin joformal, e që mund të jenë edhe mbi moshën 18 vjeçare, nuk mundet dhe nuk ka bazë ligjore që një profesor me gradën bachelor t'iu mbaj mësim joformal atyre njerëzve, unë i kam me emra dhe mbiemra se kush i ka mbajtur ato orë, madje sot do të ishte mirë të ishte prezent edhe Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë sepse ndoshta do të mund të merrte informata dhe të vazhdoj punën tutje, sepse ka fjalë që jo të gjithë ata profesorë janë paguar njëjtë por

dikush ka marrë më shumë dikush më pak, ku kanë shkuar ato mjete që janë paguar më shumë le të mbetet përgjegjësi e juaja. Në vitin 2014 edhe pse dy konkurse kanë mbetur të hapura dhe askush në muajin shtator nuk është pranuar zyrtarisht, në tetor janë pranuar fare pa konkurs dy individ të afërt të disa zyrtarëve politik të Komunës madje duke u paguar edhe për muajin shtator. Pastaj është rasti tjetër në shkollën “Jetullah Islami” në fshatin Dyz ka pesë vite që nuk shpallet konkurs fare për orët e Artit dhe të Muzikës ngase këto orë i ndanë bashkëshortja e një ish drejtori që nuk dua t’ia përmendi emrin sot e cila njëkohësisht është pranuar pa konkurs fare si bibliotekiste në kohën kur bashkëshorti i saj ishte drejtor dhe madje ajo juriste mban orët e Artit dhe Muzikës, rast i ngjashëm është edhe në shkollën fillore “Hasan Ramadani” në fshatin Shajkoc.

Kërkoj dhe shpresoj që ushtruesja e detyrës së drejtorit apo drejtoresha e tanishme e shkollës së mesme “Fan S.Noli”, z.Vlora Hajdini të mos bie nën ndikimin politik dhe të shpall konkurs për njëzet orët e lira nga lënda e Edukatës fizike, lëndë të cilat i jepte vetë para se të emërohej drejtoreshë e shkollës. Unë nuk jam në dijeni se kujt i konvenon një gjendje e tillë dhe në interes të kujt shkon i gjithë ky marifet i një politike të paskrupullt, dhe a mendohet se kështu i ndihmoni arsimit dhe fëmijëve tanë.

z.Haki Rudari, theksoi, shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së u ndërlidh me diskutimin tim në hyrje të kësaj mbledhjeje dhe përmendi politika nacionale, mirëpo unë e kam lexuar ligjin e arsimit parauniversitar ku neni 3 thotë, asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim, kjo është kompetencë e Ministrisë dhe Qeverisë, pavarësisht cilit subjekt i takon, mandej thuhet, arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore aftësuese komunale dhe Qeverisë sipas funksioneve të tyre përkatëse, pra konsideroj secili që ka funksionin dhe përgjegjësin e tij duhet të merr përgjegjësi, sikurse që kemi edhe ne këshilltarët e Kuvendit sepse jemi të votuar. Ne të cilët jemi punëtorë të arsimit, kushtimisht e them, ndoshta e ndjejmë një dhimbeje më të madhe sepse të qëndrojnë rreth 85 nxënës jashtë procesit mësimorë mendoj se nuk është në rregull. Çështje tjetër, një ditë më parë në portalin Llapi Info e lexova që Komuna e Podujevës ka ndarë rreth 36,000.00 € për rrënimin e shkollës fillore “Naim Frashëri”, kurse nxënësit e fshatit Halabak udhëtojnë më shumë se 5 km dhe kjo arsyetohet me mungesë të buxhetit, ndërsa në ligj thuhet se nxënësve të cilët udhëtojnë më shumë se 4 km duhet t’iu sigurohet transporti, kurse në të njëjtën kohë ndahen 36,000.00 € për rrënimin e asaj shkolle për të cilën po të kërkohej një aksion vullnetarë do të merrja pjesë edhe unë.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, do të filloj prej rastit të objektit të shkollës në fshatin Halabak, më 25 gusht 2015, nga drejtori i shkollës së cekur jam informuar për djegien e objektit të shkollës, përveç Drejtorive të tjera, personalisht kam dalë në vendin e ngjarjes dhe kam bërë përpjekje që menjëherë të vej kontakte me banorët e atij lokaliteti për tejkalimin e gjendjes së krijuar. Në ndërkohë më janë dërguar deklarata e Njësitit të zjarrfikësve dhe deklarata e drejtorit të shkollës përkatëse, ndërsa sipas informacioneve edhe Policia e Kosovës e ka bërë një deklaratë por ajo mua nuk më është dërguar. Të nesërmen një delegacion prej pesë personave, nuk dëshiroj t’i përmendi emrat, kanë ardhur tek unë dhe janë deklaruar se janë përfaqësues të prindërve dhe të nxënësve dhe menjëherë kemi filluar bisedat intensive në Drejtorinë e Arsimit, në zyrën e Nënkyetarit të Komunës dhe në fund në zyrën e Kryetarit të Komunës. Me atë grup i kemi shqyrtuar të gjitha mundësitë e mundshme për veprim të përbashkët, prej shumë sugjerimeve jemi përcaktuar për atë që edhe sot veprohet në atë

mënyrë që për momentin aktual, për veprim të shpejtë, me qëllim që të mos e humbet asnjë ditë e mësimi, nxënësit të integrohen në objektin e shkollës amë në të cilin ka hapësirë të mjaftueshme.

Nuk pajtohem me atë që u tha nga disa diskutues rreth largësisë që nxënësit udhëtojnë deri në shkollë ngase nuk është largësia më e madhe se dy km. e objektit të shkollës së djegur nga shkolla amë e po ashtu largësia nuk është më e madhe se katër km. prej shtëpisë së fundit deri te shkolla, edhe pse jeni në dijeni se në atë shkollë ka nxënës që vijnë nga territori i Prishtinës, edhe këta largësinë nuk e kanë më shumë se katër km.

Kryetari i Komunës, në mënyrë urgjente, më 27 gusht 2017 ju ka bërë kërkesë Ministrisë të MASHT-it dhe Ministrisë të Ministrisë së Financave që të bëjnë gjithë atë që është e mundur të përshpejtojnë ndërtimin e objektit të shkollës në fshatin Halabak, edhe pse sipas planifikimeve të MASHT-it ai objekt do duhej të ndërtohej në vitin 2016.

Delegacioni i fshatit më 2 shtator 2015 kanë bërë kërkesë në formë të shkruar përmes së cilës kanë kërkuar që mësimi të mbahet në një shtëpi private, lidhur me këtë menjëherë i kemi ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe pas vlerësimit të gjendjes sipas raportit të Drejtorisë së Arsimit për vlerësimin se objekti privat a i plotëson kushtet në aspektin pedagogjik, raportit të inspektoreve sanitare dhe raportit të inxhinierit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit është konstatuar se objekti përkatës nuk i ka plotësuar kushtet nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.

Për mua ka qenë befasi që Ministri i MASHT-it ka shkruar në fshatin Halabak, por për këtë nuk e ka informuar as Drejtorinë e Arsimit e as Institucionet tjera të Komunës ngase konsideroj se më mirë do të ishte të shkonim bashkërisht. Në takimin me banorë, sipas informacioneve që kam, Ministri ka premtuar se objekti i shkollës do të ndërtohet për tre muaj dhe se të gjithë mësimdhënësit e diplomuar do të mbeten në punë, kjo mua më ka krijuar probleme meqë, përveç një mësuesi dhe punëtorit teknik mësimdhënësit tjerë nuk kanë qenë adekuat, mirëpo në atë kohë konkursi për plotësimin e vendeve të lira ka qenë në proces dhe janë pranuar vetëm ata të cilët i kanë plotësuar kushtet dhe janë bartur në shkollën amë.

Më datën 7 shtator 2015 dy zyrtarë të Drejtorisë së Arsimit së bashku me tash ish drejtorin e sekretarin dhe mësuesit e shkollës kemi arritur që nxënësit përkatës t'i integrojmë në shkollën amë në fshatin Tërrenavë. Për fat të mirë në aspektin pedagogjik jemi në rregull ngase po flasë për nxënësit e dy shkollave ku në kl. I-rë që është numër më i madh i nxënësve por nuk e kalon normativin e lejuar të numrit të nxënësve, në klasat tjera numri i nxënësve është 28, 30, 30, 30 dhe një klasë me 34 nxënës.

Do theksuar se, hiq rastin e shkollës në fshatin Halabak, në të gjitha shkollat tjera të Komunës së Podujevës procesi mësimor ka filluar me kohë, kuptohet me disa probleme. Janë bërë të gjitha përgatitjet teknike në masën të cilat kanë qenë të mundshme me buxhetin aktual, është intervenuar në 34 objekte shkollore me ngjyrosje dhe meremetime të nevojshme dhe ndërtimin e një objekti përcjellës, shtrihet pyetja a ka pasë nevojë më tepër, sigurisht se po por siç e ceka kaq kanë qenë mundësitë buxhetore, po ashtu sipas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është bërë dezinfektimi i objekteve shkollore.

Në bazë të sugjerimeve të Drejtorive Komunale të Arsimit, MASHT-i ka ngritur një Komision për verifikimin e stoteve të librave nëpër shkolla dhe pas verifikimit ka nxjerrë një vendim shumë të qartë ku thuhet: librat bazike do të jenë së paku 30% mungesë

andaj do duhej që librat e cekura të merren nga nxënësit të cilët e kanë kryer klasën përkatëse, mirëpo kjo nuk vlen për fletore pune të lëndëve përkatëse.

MASHT-i e ka bërë listën e librave të cilat do t'i u shpërndahen nxënësve dhe kontrolli i shpërndarjes së librave nëpër shkolla do të bëhet nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të Ministrisë.

Kemi probleme sa i përket inventarit për Shkollën "Naim Frashëri" për këtë kam bërë kërkesë në MASHT, në fshatin Bajçinë ka mungesë të theksuar të hapësirës shkollore, po ashtu kemi probleme me Shkollën "Enver Maloku" kur dihet se objekti ka filluar të ndërtohet para gjashtë viteve dhe ende nuk është përfunduar e përse ka ndodhë kështu këtë duhet ta sqaroj Ministria ngase sipas kontratës përfundimi i punimeve të objektit shkollor ka qenë për dy vite ndërsa në vitin e tretë ka qenë e paraparë të ndërtohet salla sportive. Gjithashtu në aspektin fizik kemi probleme me Gjimnazin, shkollën në Llapashticë dhe Zhiti.

Drejtorja e Arsimit sërish e ka mbështetë administrimin e testit të maturantëve në afatin e gushtit dhe lirshëm mund të them se në organizimin e testit të cekur nuk ka pasë asnjë problem.

Në aspektin e përgatitjeve për plotësimin e kuadrit të nevojshëm arsimor është publikuar konkursi, kuptohet në bashkëpunim paraprak me drejtorë të shkollave, e kam ngritur Komisionin intervistues, mirëpo procedura e intervistimit, seleksionimit dhe rekrutimit ka qenë shumë e vështirë ngase gjithsej kanë qenë 725 kandidatë. Për shkak të numrit të madh të kandidatëve nuk kam pasë mundësi për të përdorë ndonjë metodologji më të avancuar të vlerësimit andaj kam bërë përpjekje që të formoj një listë të intervistuarve duke u bazuar në të dhënat e tyre personale të skanuara prej dokumentacionit përkatës dhe po e përsëris ky proces ka qenë mjaftë i vështirë ngase konkurrenca ka qenë shumë e madhe, po e përmendi vetëm një rast dhe atë në SHML Ekonomike kanë konkurruar 170 kandidatë, prej tyre 24 kanë qenë master dhe përzgjedhja është bërë me kandidatët që e kanë kryer masterin. Gjithashtu 170 gjuhëtarë kanë konkurruar për tri vende pune, prej tyre 139 i kanë plotësuar të gjitha kushtet e parapara.

Gjatë debatit u përmend mësimi zgjedhor, kjo çështje është problematike dhe duhet të shqyrtohet edhe një herë ngase mësimi zgjedhor e ka një rregull shumë e qartë dhe atë në momentin kur kryhen procedurat dhe e aprovon Drejtorja e Arsimit atëherë sipas kurikulës është mësim i obliguar, mirëpo fatkeqësisht ajo rregull në njëfarë forme ka raste kur shkelet për të plotësuar orët e një mësimdhënësi me normë jo të plotë, edhe pse ka lëndë shumë të arsyeshme, por këtë në të ardhmen besoj se do ta ndryshoj.

Për objektin e ri të Shkollës "Naim Frashëri" u tha se ka hapësirë më të vogël se objekti i vjetër, si ka ardhur deri te fillimi i realizimit të këtij projekti nuk do të lëshohem, por mund të them se përfituese për ndërtimin e objektit është një kompani shumë përgjegjëse e cila sipas të gjitha gjasave punimet do t'i përfundoj para afatit. Lidhur me këtë, problem paraqet inventari ngase me standardet që është ndërtuar shkolla nëse futet inventari i vjetër për një kohë të shkurt do të dëmtohet dysHEMEJE. Për këtë çështje me kërkesë në formë të shkruar ju kam drejtuar Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrit të Ministrisë së Financave në mënyrë që në bashkëpunim të ndërsjellë të sigurojnë inventarin e nevojshëm.

Sa i përket rrënimit të objektit të vjetër të shkollës së cekur jam në dijeni se është publikuar tenderi e kush do të jetë përfitues i tenderit kjo çështje nuk është e imja, mirëpo

rrënim i atij objekti është shumë i nevojshëm pasi që sipas projektit parashihet që në oborrin e shkollës të bëhet mbjellja e fidanëve dhe rrethoja.

Konkursi për drejtor të shkollave, nuk justifikohet siç e tha një diskutues, mirëpo në bashkëpunim me MASHT-in, ditën kur do duhej të mbahej intervistimi është dashtë të ndërpritet intervistimi, përndryshe jeni në dijeni se në Komisionin për intervistimit është edhe një përfaqësues i MASHT-it, dhe kur ai përfaqësues nuk vjen nëse bëhet intervistimi bëhet shkelje, andaj ne e kemi ndërprerë këtë çështje, por po e përsëris në bashkëpunim me Ministrinë. Do theksuar edhe këtë se sipas kriterëve aktuale nuk kemi kuadër të përgatitur për drejtor të shkollave, për këtë është në dijeni Ministri, jam unë por janë në dijeni edhe shumë të tjerë. Në një gjendje të këtillë, përfaqësuesit e MASHT-it në mënyrë të qartë na kanë thënë, merreni Ligjin për arsim dhe kriteret e Udhëzimit Administrativ përkatës dhe veproni, në bazë të kësaj ne kemi emëruar ushtrues detyre të drejtorëve të shkollave, kjo do të zgjatë derisa ne në bashkëpunim me Ministrinë na krijohen mundësitë për emërimin e drejtorëve të shkollave. Në këtë kontekst ju informoj se katër persona në tetor të këtij viti e fillojnë trajnimin e programit të menaxhimit që është kriter i akredituar prej MASHT-i. Personat përkatës që do të fillojnë trajnimin janë përzgjedhë sipas një konkursi publik të organizuar nga USAID-i. Jemi në proces të bisedimeve me USAID-in që, ashtu siç e kam kryer unë para pesë - gjashtë viteve, të gjejë mundësi që trajnimin ta organizojmë edhe në Komunën tonë së paku me 20 persona, ngase kandidati i cili i kryen dy module të programit në mënyrë automatike i lejohet emërimi në cilësinë e drejtorit të shkollës, kuptohet duke respektuar paraprakisht procedurën e konkursit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e akuzoi Ministrin e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, i cili sipas tij ka thënë se të gjithë profesorët e diplomuar nuk do të largohen nga puna, kurse drejtori vetë ai e argumentoj vërejtjet tona sepse personat adekuat nuk janë pozicionuar, pra është mirë që vetë drejtori e ceku dhe nuk po zgjerohemi më shumë në këtë temë. Çështje tjetër, rreth shkollës së fshatit Halabak, Ministri e ka cek se të gjithë profesorët të cilët janë të diplomuar dhe të cilët janë në marrëdhënie pune sepse kanë marrë akt emërimet e përgjithshme për të ligjëruar në profesionet përkatëse kurse drejtori e tha se është vetëm një profesor me kualifikim përkatës. Andaj mua personalisht më dhimbsen ata pesë mësimdhënës të asaj shkolle të cilët në këtë qeverisje do të kenë probleme sa i përket aspektit të marrëdhënies së punës, ngase ata mësimdhënës vërtetë janë munduar që diçka nga dituria e tyre t'iu japin nxënësve, por si do që të jetë me këtë problem duhet të merret drejtori i Drejtorisë së Arsimit, dhe shtrohet pyetja, përse janë mbajtur në marrëdhënie pune që 15 vite pa kualifikim përkatës ata mësimdhënës të asaj shkolle, ose përse nuk iu është dhënë hapësirë atyre mësimdhënësve t'i përfundojnë edhe provimet shpesh në mënyrë që të kualifikohen, apo përse nuk janë udhëzuar nga Drejtoria e Arsimit. Gjithashtu çështje e rëndësishme është se në këtë konkurrencë kaq të madhe të magjistrave, profileve të doktorëve ose të profesorëve të sistemit katërvjeçar, përse mbahen njerëz me shkollim të mesëm të cilët ligjërojnë në emër të profesorëve në shkolla të mesme, ndërsa drejtori në një formë u ankua duke thënë se kanë qenë 700 kandidat me magjistraturë, kurse në sistemin e arsimit mbahen njerëz të cilët janë rekrutuar me kualifikim të mesëm, nëse dëshironi ju jap edhe emrat e atyre njerëzve, pra në njërin anë drejtori ankohet se ka konkurrencë të madhe me magjistraturë kurse në anën tjetër ka të punësuar me shkollim të mesëm. Po ashtu drejtori i Drejtorisë së Arsimit e tha se nuk ka profesorë me performancë adekuate për t'i emëruar drejtorë të shkollave, kurse me një performancë të

tillë vetë drejtori i Drejtorisë së Arsimit ka marrë përgjegjësinë për të udhëhequr gjithë arsimin e Komunës së Podujevës dhe i cili vie nga pozita e drejtorit të një shkolle me performancën më të dobët nga të gjitha shkollat sa i përket testit të arritshmërisë, dua të them, sipas drejtorit të DKA-së ai e plotëson këtë performancë kurse po i njëjti i injoroi të gjithë profesorët e Llapit duke thënë se janë emëruar ushtrues detyre të drejtorëve të shkollave sepse nuk ka profesorë të cilët plotësojnë performancën përkatëse, pra kjo deklaratë e drejtorit është shumë shqetësuese. Andaj vetë argumentimi i drejtorit se në shkollën e fshatit Halabak asnjë nuk është në profil adekuat e dëshmon thirrjen e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, si dhe pozicionimi politik i drejtorit tregon se janë injoruar të gjithë profesorët duke thënë se nuk ka vende, unë jam në dijeni se Llapi ka edhe doktor shkence, profesorë, ka persona të cilët udhëheqin poste shumë të rëndësishme, ka edhe të atillë që janë kërkuar nga Komunitet tjera për të ligjruar, kështu që mendoj se deklarata e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit është mjaft shqetësuese.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, sa i përket shkollës së fshatit Halabak gjendje e jashtëzakonshme ka qenë edhe më parë sepse nxënësit e asaj shkolle kanë qenë të rrezikuar edhe nga shembja e shkollës në kohë të mësimit, mirëpo nuk do të thotë se nuk ka pasë premtime edhe më parë për ndërtimin e asaj shkolle. Konsideroj se ne duhet të angazhohemi vazhdimisht në mënyrë që objekti i ri i asaj shkolle të ndërtohet sa më shpejt, duke mos përjashtuar edhe disa shkolla të tjera të cilat nuk kanë kushte për mësim në mënyrë që të shmangim raste të tilla siç ishte rasti i shkollës së fshatit Halabak ku i tërë dokumentacioni i asaj shkolle është djegur, kështu që mendoj se duhet të intervenohet me procedura të përsheptuara në ndërtimin e objektit të shkollës në fshatin Halabak por edhe në disa shkolla tjera në të cilat nuk ka kushte të mira për mësim.

z.Haki Rudari, theksoi, me vëmendje përcjella sqarimet e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, dhe ajo që dua të them është se shumica e çështjeve apo vërejtjeve që i ngrita në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së, në një mënyrë u konfirmuan edhe nga vetë drejtori. Thirrja e kësaj mbledhjeje nuk ka pasë qëllim të politizimit ose për të kritikuar një subjekt politik, vlen të ceket se unë kam tentuar dhe provuar të bisedoj në telefon edhe me shefin e Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së për të informuar për thirrjen e kësaj mbledhjeje. Sa i përket furnizimit me libra, mendoj se Ministria përkatëse duhet të ketë në vëmendje se mësimi fillon me 1 shtator dhe të bënë përgatitjet e nevojshme me kohë, por jo të arsyetohet për këtë sepse nxënësit tanë janë ata që pësojnë. Çështja tjetër, gjendja e rëndë e arsimit në fshatrat Bajqinë dhe Llapashticë, ne jemi në dijeni se askush nuk mundet që brenda natës të rregulloj gjendjen, mirëpo është mirë që në vazhdimësi të ndërmerren këto politika, pra është mirë që në të ardhmen të dalin disa propozime të cilat do të mund të stabilizojnë dhe rregullonin gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës. Sa i përket çështjes shkollës “Naim Frashëri” në Podujevë, dy ditë më parë zëvendës drejtori i asaj shkolle më thotë se ne me padurim e presim daljen në objektin e ri të shkollës mirëpo do të kemi problem sepse do të ketë mungesë të dhomave të mësimit, pra në vend që objekti i ri shkollës të ketë më shumë dhoma të mësimit ka vetëm 14 të tilla, çështje për të cilën është dashtë që Drejtoria e Arsimit të ndërmerr masa me kohë. Prandaj i nderuari drejtor i Drejtorisë së Arsimit, qëllimi i kësaj mbledhjeje ishte që bashkërisht t'i identifikojmë problemet, të japim ide dhe bashkërisht të ngrisim cilësinë e arsimit në Komunën e Podujevës ngase është në interes të të gjithëve.

z.Flakron Gashi, theksoi, me që ekziston një Rregullore e punës së Kuvendit e cila përcakton kriteret e mbajtjes së një seance, fillimisht kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të ndërmerr masa që ata të cilët nuk janë të interesuar të dëgjojnë, dhe ata që nuk janë këshilltarë të Kuvendit dhe që nuk kanë vullnet të dëgjojnë diskutimet e këshilltarëve, ta lirojnë sallën dhe të mos e pengojnë mbarëvajtjen e mbledhjes, pra kjo le të jetë si vërejtje në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së. Nuk mora fjalën për të bërë replikë, i nderuari drejtor i Drejtorisë së Arsimit, por për t'ju dhënë më shumë sqarime dhe informata duke qenë në dijeni se sot për sot informata është gjithçka, dhe kjo është në dobi të gjendjes së Arsimit në Komunën e Podujevës. Në fillim të mbledhjes e ceka, dhe si duket del të jetë ashtu, se në qoftë se dëgjohen variantet pozitivë-opozitivë, del se jemi duke diskutuar për dy Komuna të ndryshme kurse në fakt jemi duke diskutuar vetëm për Komunën e Podujevës. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk mund të merr gjendjen pashkëputshëm nga ajo që është trashëguar, unë e kuptoj dhe pajtohem me drejtorin përkatës i cili politikisht nuk mund të jetë përgjegjës, mirëpo meqë këtu jemi për të bashkëpunuar dhe për të ngritur gjendjen dhe cilësinë e arsimit në Komunën e Podujevës, unë të jap një variant i nderuari drejtor, i ke 365 ditë të vitit kalendarik dhe me ata drejtor të shkollave të cilët i sjellin numrin e orëve dhe që i shpallin vendet e lira të punës, bashkëpunoj më shumë dhe krijoj një komision i cili do të vizitonte shkollat dhe do të shikonte se çfarë peronash çfarë orësh mbajnë dhe çfarë përgjegjësish kanë, dhe unë jam shumë i bindur se gjysmën e asaj liste që e posedoni do të rehatosh vitin e ardhshëm. Pavarësisht a e pranoni apo jo LDK-ja, kjo që po e them ka ndodhur, shumica drejtorëve të shkollave janë emisarë politikë dhe bëjnë politikë si dhe i ruajnë vendet e orëve për profesorë dhe individ të caktuar. Drejtori u ankua për numrin e madh të gjuhëtarëve të cilët janë paraqitur dhe të cilët i përmbushin të gjitha kriteret ligjore, kurse unë më parë e kam ngritur shqetësimin që persona me profesion filozofi ose gjeografi kanë dhënë gjuhë shqipe, muzikë apo edhe edukatë fizike, pra kjo është ai labirinti që është krijuar dhe nga i cili është vështirë me dalë. Gjithashtu duhet t'i bëhet një skanim secilës shkollë në nivel të Komunës së Podujevës, kriteret të cilat nuk kanë mundur t'i realizojnë, fjala është për një trajnim dhe për këtë drejtori i Drejtorisë së Arsimit është në dijeni shumë mirë se ka drejtorë të shkollave të cilët nuk kanë mundur ta kalojnë atë test, kurse tani thuhet nuk kemi kuadro, unë pyes kush me i përgatit kuadrot, andaj Drejtoria e Arsimit në të ardhmen duhet të mendojë më mirë se këndë po e dërgon në ato trajnime, mos të dërgohen studentë ose të atillë me bachelor, por të dërgohen persona profesionist që i përmbushin kushtet sipas kriteve që në të ardhmen të jenë drejtor të shkollave. Kështu që i nderuari drejtor gjërat që unë i ceka mos i merr si replikë apo me inate personale sepse askush me zor nuk na ka shty të jemi në këto pozita që jemi por merri si informata sepse të nevojiten shumë dhe të jesh i bindur se këto që u thanë këtu dhe ata emra që i posedojmë por për hirë të korrektësisë dhe familjeve të tyre nuk dëshirojmë t'i bëjmë publike, janë fakte të vërteta të provuara, kurse nuk mund të thotë askush se ata njerëz nuk janë pjesë e arsimit në Komunën e Podujevës sepse gjendja jonë është kjo që është, nuk është gjendja vetëm a janë shpërndarë tekstet shkollore me kohë, a janë pranuar me kohë pastaj a ka pasë të interesuar dhe a ka pas konkurrencë, por duhet të shikohet gjendja brendapërbrenda çfarë është.

z. Shaban Osmani, theksoi, lidhur me thirrjen e kësaj mbledhje të jashtëzakonshme, fillimisht kam menduar se kemi të bëjmë me gjendjen e krijuar në fshatin Halabak, mirëpo tani doli të jetë krejt tjetër gjë megjithëse material-informatë nuk kemi për gjendjen e arsimit. Rreth gjendjes së krijuar në fshatin Halabak, më i përgjegjshmi ishte z. Kadri Avdiu i cili e tregoj gjendjen e vërtetë ashtu siç ka qenë, ne jemi në dijeni se në projekte për vitin 2016 ka qenë edhe ndërtimi i shkollës në fshatin Halabak, mirëpo unë me plotë bindje e them se shkolla e fshatit Halabak është djegur qëllimisht për interesa të personave të ndryshëm nga radhët e LVV-së dhe PDK-së me qëllim që të bëhet problem shkolla e fshatit Halabak. Unë ju bëj thirrje të gjitha organeve të merren me zbulimin e së vërtetës sepse konsideroj se shkaktarë kryesorë është njeriu, kush mund të jetë me emër nuk jam në dijeni, mirëpo mendoj se zjarri vetvetiu nuk ka shpërthyer.

Pavarësisht se nuk kishim një material për gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës, drejtori i Drejtorisë së Arsimit e dha një informatë shumë të mirë dhe mjaft domethënëse për gjendjen e arsimit. z. Haki Rudari vazhdimisht kërkon debat, por nuk di se çfarë debati mund të bëhet pa pasur material apo informatë përkatëse, dhe nuk di si mund t'i arrij të gjitha këto dhe nuk di se a merret ndonjëherë me punën e vetë profesionale që e ka.

Jam në dijeni se gjithëherë opozita ka të drejtë të shqetësohet mirëpo edhe ne si pozitë shqetësohemi kur është fjala për shkolla e gjëra të ngjashme, dhe çdoherë kur kemi material edhe ne jemi të gatshëm të debatojmë. Pra konsideroj se shumë më mirë do të ishte që në mbledhjen e radhës të debatonim për fillimin e vitit të ri shkollorë ku sigurisht se do të kishim para vetës edhe materialin përkatës në bazë të cilit do të mund të bëhej debat, por meqë është kërkuar të bëhet kjo sot, mendoj se në mbledhjen e radhës nuk kemi çka të debatojmë më për këtë çështje sepse të gjitha rreth arsimit u thanë sot.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, meqë jemi në demokraci unë e respektoj mendimin e secilit duke përfshirë edhe atë të parafolësit, mirëpo rreth djegies së shkollës në fshatin Halabak nuk mund të pranojmë etiketimin që parafolësi e bëri ndaj PDK-së dhe LVV-së. Publikisht në emër të PDK-së dega Podujevës i bëj ftesë z. Shaban Osmanit, në çiftë se ka njohuri ose ka informata se kush është dorasi i djegies së asaj shkolle, unë personalisht do të dërgoj në secilin organ dhe institucion të rendit vetëm e vetëm që të gjendet autori i djegies. E respektoj moshën dhe kontributin e parafolësit dhe e sugjeroj të jetë i bindur se nuk dëshiroj të polemizoj në baza politike-partiake, mirëpo mora fjalën ngase rreth djegies së shkollës në fshatin Halabak parafolësi e tha se bënë pjesë edhe PDK-ja.

Kjo mbledhje nuk është thirr vetëm për shkollën e fshatit Halabak dhe Partia Demokratike e Kosovës nuk e ka përkrahur këtë thirrje vetëm sa për të bërë debat, por e kemi përkrahur këtë mbledhje për të kërkuar llogari nga kjo qeverisje, pra ky është qëllimi, unë e kam njoftuar Kryesuesin e Kuvendit se Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së nuk i ka dhënë nënshkrimet për thirrjen e kësaj mbledhjeje vetëm sa për një mëditje, dhe jemi të gatshëm të marrim pjesë në të gjitha mbledhjet pa pasur mëditje fare vetëm e vetëm për t'i vënë gjërat në vend. Pra në këtë mbledhje në fokus është shkolla e fshatit Halabak dhe punëtorët e asaj shkolle për të cilët mendoj se Kryetari i Komunës ose drejtori i Drejtorisë së Arsimit duhet të marrin një vendim rreth largimit të tyre nga puna ose pagesës së tyre, po ashtu jemi në këtë mbledhje sepse gjendja në arsim është reale dhe për këtë drejtori i Drejtorisë së Arsimit duhet të jep llogari, përse në arsimin e mesëm ligjërojnë persona me shkollim të mesëm, përse drejtori e thotë se në Llap nuk ka kandidat për drejtorë të shkollave kur kemi parasysh faktin se po ai vetë me një përgatitje të tillë është drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Prandaj edhe njëherë e përsërisë, në emër të

Partisë Demokratike të Kosovës dega në Podujevë, që nga ky moment shprehi gatishmëri të veprojmë me parafolësin, madje me veturë dhe shpenzime personale në mënyrë që të gjejmë autorin e djegies së shkollës në fshatin Halabak, ne e kemi mbështetur thirrjen e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme mirëpo secili prej subjekteve në këtë Kuvend i kemi politikat dhe programet e ndryshme të qeverisjes.

z.Shaban Osmani, theksoi, sa i përket çështjes për të cilën po debatohet e që ka të bëjë me djegien e shkollës në fshatin Halabak, unë nuk përmenda asnjë emër, dhe e ceka shumë kartë se nuk jam në dijeni me emër kush mund të jetë, kurse parafolësin falënderoj për gatishmërinë që e shprehi për të më vozitë me veturë të tij, por nuk kam nevojë për një gjë të tillë. Gjithashtu i falënderoj iniciuesit e kësaj mbledhjeje sepse vërtetë për dallim nga disa këshilltarë tjerë unë personalisht kam nevojë për mëditje.

z.Haki Rudari, theksoi, me gjithë respektin për moshën e parafolësit, por dua të them se unë jam një ndër ata punëtorët e arsimit që kemi punuar edhe pa pagesë me vite të tëra dhe këtë e din edhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit, dhe nuk kam problemë për pagesë-mëditje sepse i kam dy vëllezër në Gjermani dhe vetë punoj në arsim. Megjithatë pagesa-mëditje të tilla në të ardhmen mund të ketë më shumë sepse kjo mbledhje është vetëm fillimi, kurse iniciativa për mbledhje të jashtëzakonshme do të ketë shumë në të ardhmen, pa marrë parasysh kush është iniciues i mbledhjeve të tilla madje qoftë edhe pozita ne do të përkrahim nëse kemi të bëjmë me interes të përgjithshëm, kurse sa i përket asaj që unë kam vullnet dhe elan për punë mund të them se është meritë e imja dhe e familjes time dhe është kontribut i imi, andaj nuk dua të ndalem në këtë, por dua t'ju them se për aq sa do të kem shëndet nuk do të ndalem së punuari dhe angazhuari. Pra nuk ishte qëllimi i kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme vetëm mëditja ashtu siç e tha parafolësi. Gjithashtu jemi në dijeni se Ministrinë e Punëve të Brendshme e udhëheqë LDK-ja, andaj për çdo informatë që mund të keni rreth djegies së shkollës në fshatin Halabak mund t'i drejtoheni policisë, por nuk është mirë që të bëhen etiketime, siç i bëri parafolësi im. E falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për sqarimet dhe informatat e dhëna mirëpo unë prita më shumë nga ai që të kontribuojë në këtë drejtim.

z.Kadri Avdiu, theksoi, çështja që ka të bëjë me shkollën e fshatit Halabak tani veç u sqarua, mirëpo nuk do të doja dhe me keqardhje po e them që fatkeqësia e nxënësve të fshatit Halabak nuk bënë të keqpërdoret për çështje politike. Kjo që po e them vlen për të gjithë ne pozitë-opozitë, nëse kemi qëllim dhe ndiejmë dhimbje shpirtërore për fëmijët e fshatit Halabak, por edhe për të gjithë të tjerët kudo që janë, atëherë nuk kemi nevojë të merremi me çështje politike-partiake, dhe të mos keqpërdoret politikisht fatkeqësia e atyre nxënësve, por t'iu bëhet zgjidhja atyre nxënësve. Sa i përket thirrjes së kësaj mbledhjeje, unë personalisht nuk ndihem mirë kur dëgjoj se kjo mbledhje është thirr për arsye financiare e gjëra të ngjashme, Kryesuesi i Kuvendit e ka respektuar ligjin ku me nënshkrimin e këshilltarëve për një mbledhje të tillë është konstatuar gjendje e jashtëzakonshme pastaj është thirr mbledhje e jashtëzakonshme, por asesi nuk bënë të keqpërdoret shkolla e fshatit Halabak për çështje politike.

z.Naim Çunaku, theksoi, jemi në një mbledhje të jashtëzakonshme dhe sigurisht se iniciuesit e kësaj mbledhjeje i kanë parashtruar vetës qëllimin se çka dëshirojnë të arrijnë me këtë mbledhje, ndërsa ajo që mua shtyri të marrë fjalën është se deri tani nuk dëgjova asgjë konkrete, asnjë konkluzion dhe asnjë gjetje për një rrugëdalje se çka më tutje është qëllimi i kësaj mbledhjeje. Nëse kjo mbledhje është thirr për të shfryrë mllfet dikush për gjëra personale dhe dikush për çështje tjera politike, por pa dhënë një udhërrëfyes

gjegjësisht një konkluzion se çka më tutje t'i kontribuojmë asaj situatë. z.Kadri Avdiu e tha shumë mirë, mos të keqpërdoret fatkeqësia e nxënësve të fshatit Halabak ngase ka ndodhë ajo çfarë ka ndodhë, kurse tani në këtë foltore pati diskutime ku dikush thotë se shkolla është djegur me qëllim, dikush tjetër diskuton se a ka apo nuk ka nevojë për mëditje e gjëra të ngjashme, mirëpo si finalizim unë nuk po shoh asgjë konkrete deri më tani, kurse qëllim i çdo mbledhje të jashtëzakonshme është të trajtohet një çështje e jashtëzakonshme dhe asaj çështjeje t'i jepet një rrugëzgjdhje ose të tentohet t'i jepet një rrugëzgjdhje.

z.Avni Ajeti, theksoi, megjithëse ne të gjithë vazhdimisht në këtë Kuvend debatojmë për arsimin dhe për përkrahje dhe përkushtim për fëmijë dhe nxënës, unë kam pyetje për të gjithë këshilltarët e Kuvendit të cilët janë edhe mësimdhënës, sa prej juve i keni lënë sot nxënësit e juaj pa e mbajtur orën përkatëse të mësimin.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, lidhur me çështjen që z.Rafet Llapashtica e ceku, ju informoj se në këtë vit janë pranuar 30 mësuese me program të mësuesërisë ose programi SHLP siç quhet ndryshe dhe askush nga ato nuk është pranuar në baza partiake. Çështja tjetër, nuk është e vërtetë se kemi arsimtarë të padiplomuar, por ata arsimtarë janë me profil të caktuar, mirëpo sipas një vendimi të MASHT-it dhe Udhëzimit Administrativ përkatës që e rregullon këtë çështje, të gjitha atyre të cilët janë në sistem dhe që kanë më shumë se tri vite përvojë duhet t'iu jepet mundësia që deri në vitin 2016 të rikualifikohen. Sa i përket konkursit, unë e thash dhe po e përsërisë, se asnjë person nuk është pranuar me shkollë të mesme, mirëpo ka të atillë që janë duke punuar me shkollë të normales dhe të cilët janë para pensionit, shkollë e cila në atë kohë ka qenë shkollim i lartë dhe kualifikim në bazë të cilit në kohën e punësimit të tyre janë përmbushur kriteret, pra ligji i cili e rregullon këtë fushë nuk na kthen në kohë, prandaj ne duhet të mbajmë ata persona në punë deri sa të dalin në pension sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Sa i përket shkollës së fshatit Halabak e cila është djegur, për mua personalisht si drejtor i Drejtorisë së Arsimit e rëndësishme ka qenë që ata nxënës të kthehen në bankat shkollore dhe të vijojnë mësimin pavarësisht se në cilën shkollë, e që për fat të mirë të gjithë nxënësit e shkollës Halabak tani vijojnë mësimin, çështje të cilën do ta monitoroj vazhdimisht por edhe kërkoj të gjithë ju që jeni nga ai lokalitet të më njoftoni rreth atij procesi mësimorë, pra mos të keqpërdoret kjo foltore dhe të mos keqpërdoret shkolla tash më e djegur e fshatit Halabak për qëllime tjera.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12;05

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-81276
Podujevë,
10 shtator 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**